

Në bazë të nenit 17 të Vendimit për punën e Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit, Këshilli për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit në seancën e mbajtur më 30 maj 2019, shpall

## **KONKURS për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit për vitin 2019**

1. Çmimi “13 Nëntori” i qytetit të Shkupit u ndahet **personave fizik dhe juridik** si shenjë mirënjojeje e Qytetit të Shkupit, për **arritje**, në ekonomi, shkencë, art, kulturë, edukim dhe arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale, sport dhe kulturë fizike, kulturë teknike, mbrojtje dhe përmirësim i ambientit jetësor dhe natyrës, si dhe në segmente të tjera të jetës, punës dhe krijimit, që përbëjnë **kontribut të veçantë dhe për zhvillimin e Qytetit dhe për përparimin e përgjithshëm e afirmimin** në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë.
2. Çmimi për arritje të rëndësishme në fushat e pikës së mëparshme u ndahet edhe personave fizik dhe juridik **nga shtete të tjera**.
3. **Studentëve dhe nxënësve** Çmimi u ndahet për punë krijuese ose arritje të suksesshme në kontinuitet në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore që përbëjnë një kontribut të veçantë për përparimin dhe afirmimin e Qytetit të Shkupit.
4. Çmimi ndahet për arritje në **periudhën e kaluar prej një viti** (ilogaritur deri në përfundimin e konkursit), si dhe për një periudhë më të gjatë që përbën **përbillyjen e një pune krijuese ose në kontinuitet në tërsi**.
5. Për individë, grupe krijuesish, nxënës dhe studentë Çmimi përbëhet nga **diploma dhe shumë në të holla**.
6. Çmimi për persona juridik nga vendi dhe persona juridik nga shtete të tjera përbëhet nga **diploma dhe pllakate**.
7. Të drejtën për propozimin e kandidatëve për Çmimin “13 Nëntori” kanë persona juridik dhe fizik.
8. Çmimi mund t'i ndahet përsëri fituesit të mëparshëm, por jo para afatit prej 10 viteve nga marrja e çmimit të fundit.
9. Propozimi për Çmimin duhet të arsyetohet në mënyrë të hollësishme, kurse për kandidatë individë duhet të ketë edhe biografi.
10. Bashkë me propozimin për ndarjen e Çmimit për vepra të botuara dhe botime të tjera bashkëngjiten edhe (2) ekzemplarë të veprës.
11. Konkursi zgjat deri më 10 shtator 2019.

Parashtruesi duhet të japë emërtimin e tij të plotë, adresën dhe numrin e telefonit.

Formulari për konkurrimin për Çmimin “13 Nëntori”, mund të merret në zyrën pritëse të Qytetit të Shkupit ose të gjendet në ueb faqen [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).

Propozimet i dorëzohen në tre kopje Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit (Qyteti i Shkupit – Parku i Qytetit, bul. Ilinden numër 82), zyra pritëse.

Informacion në tel. 3297-358 dhe 3297-242.

**Numër 27-5262/1**

**30 maj, viti 2019**

**KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMIT  
“13 NËNTORI” TË QYTETIT TË SHKUPIT**